



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:238692
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626301

C-IV-15-1564

Parashtruesi i ankesës; R N Republika e Serbisë.

Pala kundërshtare; Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit; Asllan Krasniqi me datën;26.04.2024 merr këtë;

A K T V E N D I M

Ankesa e ushtruar nga R N konsiderohet e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën; 13.06.2023, ka hartuar me shkrim vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për parashtruesen e ankesës duke e detyruar të njëjtën që pagesën ta kryej në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të kësaj vërejtje. Meqenëse vërejtja e hartuar nga gjykata nuk ka mundur t'i dorëzohet në adresën e dhënë në ankesë, gjykata me datën 22.03.2024, vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë e ka afishuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate duke e ftuar parashtruesen e ankesës që brenda afatit prej 15 ditëve ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore për ankesë. Në shkresat e lëndës rezulton se parashtruesja e ankesës edhe përkundër faktit të vërejtja për pagesën e taksës ka qëndruar në tabelën e shpalljeve deri me datën 02.04.2024, në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se pagesa është kryer.

Arsyetimi ligjor;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit duke iu referuar shkresave të lëndës ka konstatuar se parashtruesja e ankesës edhe përkundër faktit se vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë është afishuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate nga data 22.03.2024, e deri me datën 02.04.2024, nuk e ka paguar taksën gjyqësore në afatin kohor prej 15 ditëve.

Andaj gjykata duke iu referuar dispozitës së nenit 253 paragrafi 5 të LPK-së ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

Ndaj këtij aktvendimi parashtruesja e ankesës mund të ushtroj ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke llogaritur nga data e pranimin të këtij aktvendimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi